



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË

Drejtoria e Politikave & Zhvillimit të Hidrokarbureve

[REDACTED] rot.

[REDACTED] 2014

Drejtuar: Z. Damian Gjoknuri
Ministër i Energjisë dhe Industrisë

Lënda: Raport nga Grupi i Punës, për kontrollin e aktivitetit të kompanive që kryejnë operacione hidrokarbure, në kuadër të Marrëveshjeve Hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në territorin shqiptar (tokë dhe det).

Z. Minister,

Ne zbatim të Urdherit Nr. 68, datë 07.02.2014, "Për ngritjen e Grupit të Punës, për kontrollin e aktivitetit të kompanive që kryejnë operacione hidrokarbure, në kuadër të Marrëveshjeve Hidrokarbure për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në territorin shqiptar (tokë dhe det)", grupi i punës në përberje të të cilit janë specialiste të MEI, AKBN-se dhe Albpetrol-it, punoi gjatë kësaj periudhe për analizën ecurisë së realizimit të Marrëveshjeve Hidrokarbure në fuqi. Kjo analizë e aktivitetit të punës së kompanive konsiston në:

- Zbatimin e Planeve të Zhvillimit, Programeve të Punës dhe Buxheteve vjetore nga shoqëritë që janë duke kryer operacione hidrokarbure në kuadër të MH për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet ekzistuese, siç përcaktohet në MH përkatëse;
- Zbatimin e Programeve të Punës dhe Buxheteve vjetore në kuadër të planifikimit për Periudhën e Kërkimit, nga shoqëritë që janë duke kryer operacione hidrokarbure në kuadër të MH për kërkimin dhe zbulimin e hidrokarbureve në blloqet e reja të kërkimit, siç përcaktohet në MH përkatëse;
- Raportimet financiare sipas përcaktimeve të Marrëveshjeve Hidrokarbure;
- Menyrën e aplikimit të teknologjisë më të avancuar gjatë gjatë operacioneve, për të garantuar një shfrytëzim racional të vendburimeve ekzistuese dhe/ose të atyre që do të zbulohen;
- Vlerësimin dhe kontrollin e shpenzimeve të realizuara gjatë kryerjes së operacioneve hidrokarbure në kuadër të marrëveshjeve hidrokarbure ekzistuese;

- Kontrollin, analizen dhe vleresimin e perfitimeve konkrete qe duhet te arrije Shteti nga realizimi i ketyre marreveshjeve Hidrokarbure;
- Vleresimin konkret per zbatimin e afateve dhe procedurave administrative, qe lidhen me pergatitjen dhe miratimin e dokumentave qe menaxhojne Marreveshjet Hidrokarbure ballafaqur me percaktimet me Marreveshjet dhe License Marreveshjet perkatese;
- Vleresimin konkret lidhur me situaten aktuale qe konstaton grupi i Punes, lidhur me zbatimin korrekt te kerkesave te legjislacionit ne fuqi.

Ne perfundim grupi i punes po ju paraqet problemet qe u evidentuan gjate kesaj analize, si dhe nje informacion me te detajuar per ecurine e te gjitha Marrëveshjeve Hidrokarbure qe nga fillimi i tyre. Aktualisht jane ne fuqi gjithsej gjashte Marrëveshje Hidrokarbure, te cilat po i rendesim me poshte:

1. Marrëveshja për Bllokun e Durrësit, ne det, me kompaninë San Leone Energy.
2. Marrëveshja për Bllokun Joni 5, ne det, me kompaninë Capricorn Albania Ltd dhe Dyas Albania B.V.
3. Marrëveshja për Blloqet 2, 3 dhe 4, në det, me kompaninë Emanuelle Adriatic Limited.
4. Marrëveshja për Bllokun “F”, ne toke, me kompanine Bankers Petroleum Albania.
5. Marrëveshja për Blloqet “2-3”, ne toke, me kompanine Petromanas.
6. Marrëveshja për Blloqet “D-E”, ne toke, me kompanine Shell & Petromanas.

Ne vijim po paraqesim ne menyre te permbledhur problematiken qe u evidentua gjate kesaj analize per secilen prej marreveshjeve:

1. Marrëveshja për Bllokun e Durrësit, ne det, me kompaninë San Leone Energy

Vlerësimi konkret për zbatimin e afateve dhe procedurave administrative.

Kontrata me ndarje prodhimi për bllokun e Durrësit në det, fillimisht është lidhur me kompanitë OMV (Albanian) Adriatic Sea Exploration GmbH dhe Lundin Netherlands B.V. me nga 50% të interesave dhe operator OMV, me VKM. 562, datë 27.08.2004. OMV, i transferoi interesat e saj në bllokun e Durrësit, në vazhdimësi, kompanisë Island International Exploration B.V. Në tetor 2007, kompania Lundin Netherlands B.V.i kalon 50% të interesave të saj, në bllokun Durrësi, kompanisë Island International Exploration B.V.

Në mars 2008 kompania Island International Exploration B.V, kalon 25% të interesave të saj te kompania Beach Petroleum Limited. Në janar 2010, Beach Petroleum Limited, ndryshoi emrin në Beach Energy Limited.

Në Shtator 2011, interesat e kompanisë Island International Exploration B.V janë blerë nga San Leon Energy Plc. Më 16.02.2012 edhe Beach Energy Limited, i kalon 25% të interesave të tij në bllokun e Durrësit, kompanisë San Leon Energy, i cili bëhet kështu zotëruesi i 100% të interesave në bllokun e Durrësit.

Kalimet e interesave kanë ndodhur në Periudhën e parë të kërkimit, të cilat kanë dashur kohë dhe për këtë arsye kompanitë kanë kërkuar zgjatjen e Fazës së parë me një vit, kërkesë për të cilën është dhënë miratim nga Ministri.

Pas analizës së të gjitha të dhënave në dispozicion, kontraktori arriti në konkluzionin që, nuk kishte asnjë strukturë të gatshme për shpim dhe në këto kushte, nuk justifikohet ndërmarrja e këtij investimi në procesin e negocimit për rentën minerare. Gjatë negocimit të termave të përshtatshëm, për shmangien e efektit të rentës minerare, u propozua nga kompania ndryshimi i detyrimit të shpimit të pusit, me detyrimin e kryerjes së punimeve sizmike 3D, duke mbajtur të pandryshuar detyrimin financiar, kërkesë e cila mbështetur në argumenta teknike, është pranuar nga AKBN.

Në fillim të vitit 2010, mes AKBN-së dhe kontraktorëve, u arrit marrëveshja për Amendamentin e KNP, e cila, pasi u miratua nga Ministri i Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës, më datë 13 janar 2010, u miratua nga Këshilli Ministrave me VKM Nr.42 Prot, datë 12.01.2011, u botua në Fletoren Zyrtare Nr.6, datë 31.01.2011.

Elementët kryesorë të kësaj marrëveshje janë:

- Përcaktimi i Periudhës së parë të kërkimit, me 5 vjet (për shkak të procedurave të shumta të ndodhura në këtë periudhë).
- Periudha e tretë e kërkimit u vendos të ishte 1 vit.

Programet e Punës dhe Buxhetet Vjetore

Marrëveshja (e amenduar), parashikonte që kontraktori, gjatë Periudhës së parë të kërkimit, të kryejë:

- Ripërpunimin e 1,000 km sizmike ekzistuese 2D.
- Punime të reja sizmike 3D, në një volum 740 km.

Kompania realizoi të gjitha detyrimet kontraktuale të Fazës së parë dhe me shkresë Nr.6301, datë 14.12.2011, ka deklaruar futjen në Fazën e dytë të kërkimit. Per kalimin në Fazën e Dytë kompania depozitoj Garancinë Bankare me shkresën Nr. 142/2014 Prot, datë 06.01.2014. Për këtë fazë, e cila do të zgjasë një vit, parashikohet të përmbushen këto detyrime

- Të shpojë një pus me një investim jo më pak se 2,000,000 USD.

Shtesa e parë e Marrëveshjes Hidrokarbure, miraton kërkesën e Palëve në këtë marrëveshje, për pezullimin e të gjitha detyrimeve të kompanisë për periudhën 26.08.2008 – 31.01.2011 (Neni 3.8).

Me shkresën Nr.4110, datë 07.10.2011, kompania parashtrroi kërkesën për zgjatjen e Fazës së dytë të kërkimit me një vit. Në parim AKBN ra dakort dhe kërkoi miratimin në METE me shkresë dt. 29.12.2011. Pas aprovimit të METE-s, u ratifikua nga Këshilli Ministrave, me VKM Nr.588 Prot, datë 30.05.2013 dhe u botua në Fletoren Zyrtare Nr.126, datë 31.07.2013.

Kjo është quajtur Shtesa e dytë e Marrëveshjes Hidrokarbure.

Në këtë shtesë përcaktohet:

- Periudha nga 30.01.2012–30.07.2013 do të konsiderohet Periudhë Pezullimi (Neni 3.9).
- Periudha nga 31.07.2013–31.07.2015, është Periudha e dytë e kërkimit, ku kompania do të shpojë 2 puse me një investim jo më pak se 5 milionë USD.

Periudha e tretë e kërkimit, e parashikuar në Nenin 1.49 të Shtesës së parë, shfuqizohet. Interesat e pjesëmarrësve të shoqërive janë: San Leon Energy ka 100% të interesave.

Faza ku ndodhen tani punimet, është Faza e fundit, e cila mbaron më **31.07.2015**.

Raportimet financiare

Vlera totale e investimit deri në fund të vitit 2013, arrin 19,3 milionë USD.

Vlerësim konkret lidhur me situatën aktuale në zbatimin korrekt të kërkesave të legjislacionit në fuqi

Sipas AKBN, kompania ka depozituar Garancinë Bankare për Fazën e dytë të kërkimit, dërguar me shkresën Nr.142, datë 06.01.2014.

Konkluzione.

Nga dokumentat e paraqitura nga AKBN për këtë kompani, te raportimet financiare paraqitet vetëm vlera totale e investimit deri në fund të vitit 2013.

2. Marrëveshja për bllokun Joni 5, me kompanitë Capricorn Albania Limited dhe Dyas Albania B.V.

Vlerësimi konkret për zbatimin e afateve dhe procedurave administrative.

Në bllokun Joni 5, në det, ushtron aktivitet kompania Capricorn Albania. Marrëveshja është firmosur nga Palët, në datë 04.09.2006, është ratifikuar nga Këshilli i Ministrave në datë 08.08.2007, me vendimin Nr.507 dhe botuar në Fletoren Zyrtare Nr.112, datë 24.08.2007. Data efektive e kësaj kontrate është 09.09.2007.

Marrëveshja fillimisht është lidhur me kompaninë britanike MedOil, e cila në vitin 2008 u ble nga kompania skoceze Cairn Energy dhe kjo e fundit, ja transferoi interesat e projektit të bllokut Joni-5, filialit të saj Capricorn Albania Limited. Në shkurt të vitit 2010, Capricorn Albania Ltd, i transferoi kompanisë Dyas Albania B.V, 15% të interesave të saj në këtë marrëveshje.

Për këtë marrëveshje, fillimisht është kërkuar një amendament për zgjatjen e periudhës së kërkimit me një vit. Kjo për shkak të vonesave për transaksionet e sipërpërmendura për blerjen e kompanisë MedOil si dhe kohën që i duhet kompanisë për gjetjen e një anijeje të përshtatshme për kryerjen e punimeve 3D në det. Me shkresën Nr. 1505/4, datë 04.03.2009, Ministri jep miratimin e kësaj kërkesë dhe nisjen e procedurave.

Dalja e Ligjit të rentës minerare, detyroi AKBN dhe kompaninë, të amendojnë dhe kushte të tjera të kontratës, për të reflektuar ndikimin që ka ky ligj në këtë marrëveshje. Kontrata e amenduar u firmos nga AKBN dhe Ministria dhe që prej vitit 2010 pritej për tu kaluar për miratim në Këshillin e Ministrave. Gjatë kësaj kohe pritje, kompania pezulloi punimet e kërkimit dhe ka pritur miratimin e kontratës me amendamentet përkatëse. Amendimi i Marrëveshjes Hidrokarbure, i miratuar nga AKBN dhe METE në vitin 2010, u ratifikua nga Këshilli i Ministrave me vendimin Nr.529, datë 13.06.2013, duke konsideruar

të pezulluar operacionet për periudhën 09.08.2009 – 16.07.2013. Ky vendim e zgjati me një vit Fazën e parë të kërkimit, e cila i korespondon periudhës 17.07.2013 – 17.07.2014.

AKBN është njoftuar me datën 14 Janar 2014 nga kompania Orion Energy Ltd, se kjo e fundit ka marrë të drejtat dhe detyrimet e kompanisë Capricorn Albania Ltd, e cila është palë në Marrëveshjen Hidrokarbure me ndarje prodhimi për Bllokun e kërkimit Joni-5, në det. Për këtë qëllim Orion Energy Ltd ka paraqitur një set dokumentash me anë të të cilave prezantohet në AKBN si pasardhëse e kompanisë Capricorn Albania Ltd.

AKBN pasi shqyrtojë të gjithë dokumentacionin e paraqitur nga kompania Orion Energy Plc, në respektim të Ligjit Hidrokarbur, Nr. 7746, datë 28.07.1993, dhe Marrëveshjes Hidrokarbure për Bllokun Joni-5, për rastet e shitjes ose kalimit të interesave, nga një kontraktor në një tjetër, ju pergjigj kesaj kompanie me letren Nr. 813/1 Prot te dates 09.04.2014, ku nuk njeh kalimin e të drejtave dhe detyrimeve, nga Capricorn Albania Limited tek Orion Energy Plc, pasi është në kundërshtim me parashikimet e MH dhe Ligjin e Hidrokarbureve.

Pra sipas të gjitha parashikimeve të marrëveshjes, kalimi i të drejtave dhe detyrimeve, nga Capricorn tek Orion Energy Plc, nuk mund të realizohet pa miratimin e AKBN-se, në kushtet që ky kalim nuk përfshihet në ato raste që parashikon marrëveshja.

Programet e Punës dhe Buxhetet Vjetore.

Marrëveshja parashikon kryerjen e operacioneve të kërkimit në 3 faza, ku në Fazën e parë, e cila parashikohet të zgjasë 2 vjet, kontraktori ka detyrimin për :

- Ripërpunimin e 100 km sizmike ekzistues 2D, me shpenzim minimal 50,000 USD.
- Kryerjen e 400 km² punime të reja sizmike 3D, me shpenzim minimal 2,000,000 USD.

Kompania, për Fazën e parë të kërkimit, ka përfunduar punimet sizmike 3D në vitin 2009, por nuk ka realizuar ripërpunimin e 100 km sizmike ekzistues 2D, duke nxjerrë si arsye se bobinat janë një kopje e vetme dhe se nuk është gjetur një zgjidhje se si mund të kryhet ky proces,

Raportimet financiare

Investimi total i kompanisë deri në fund të 3-mujorit të tretë të vitit 2013, është 9,744.⁰⁹ USD.

Konkluzione.

Për Fazën e parë të kërkimit kompania ka plotësuar pjesërisht detyrimin kontraktual.

3. Marrëveshja për bllokun “F”.

Marrëveshja me ndarje prodhimi, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në tokë, në Shqipëri, për bllokun “ F”, e nënshkruar midis AKBN dhe Bankers Petroleum, më datë 09.04.2010,

është miratuar nga Këshilli Ministrave, datë 17.11.2010 dhe është botuar në Fletoren Zyrtare Nr.169, datë 17.11.2010. Data efektive e kësaj marrëveshje është 17.11.2010.

Programet e Punës dhe Buxhetet Vjetore.

Kompania ka paraqitur Programet e Punës dhe Buxhetet Vjetore për Fazën e parë të kërkimit, të cilat janë miratuar nga Palët në mbledhjet e Komitetit Këshillimor

Vlerësimi konkret për zbatimin e afateve dhe procedurave administrative që lidhen me përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve që menaxhojnë marrëveshjet hidrokarbure.

Faza e parë e kërkimit ka zgjatur për një periudhë 3-vjeçare, nga data 17.11.2010–16.11.2013 dhe kompania kishte si detyrim

- Kryerjen e studimeve gjeologo-gjeofizike (G&G) me një detyrim financiar 900 mijë USD.
- Ripërpunimin e 400 km profile sizmike 2D, me një detyrim financiar 100 mijë USD.
- Shpimin e dy puseve me një thellësi jo më të vogël se 2000 m, me një detyrim financiar 4 milion USD.

Është realizuar një studim G&G me një kosto prej 1.021.728 USD.

Jane përpunuar 700 km profile seizmike 2D, me një kosto prej 411,508 USD;

Janë shpuar dy puse me një kosto totale prej 4,879,888 USD.

Nga të dhënat G&G, të marra nga të dy puset e shpuar, u arrit në përfundim se; në këto puse nuk shfaqen objektet e parashikuara në projekt. Kompania ka plotësuar dhe dërguar në AKBN planet e abandonimit të dy puseve të shpuar, duke marrë dhe miratimin nga AKBN. Kompania ka përfunduar Fazën e parë të kërkimit dhe ka kërkuar futjen në Fazën e dytë më datë 08.10.2013. Eshtë miratuar nga Komiteti Këshillimor më datë 28.01.2014.

Raportimet financiare

Në zbatim të KNP, nga kompania Bankers Petroleum, janë dërguar në AKBN; (nga materialet e vëna në dispozicion), situacionet ekonomike të raportuara për çdo periudhë 3-mujore, për Fazën e parë të kërkimit.

Vetëm për periudhën nëntor 2010 – mars 2011 situacionet ekonomike nuk janë të raportuar në 3-mujorë, por janë të përfshira në evidencat mujore Cost Recovery Statement të Bankers Petroleum.

Në total, kompania për Fazën e parë të kërkimit, ka shpenzuar 6,570,480 USD, nga 5,000,000 USD të parashikuara për këtë fazë.

Vlerësimi dhe kontrolli i shpenzimeve të realizuara në Fazën e parë të kërkimit.

Nga AKBN janë kryer auditime për shpenzimet e operacioneve hidrokarbure nga kompania Bankers Petroleum :

- Auditimi për periudhën 17.11.2010 – 31.03.2013
- Auditimi për periudhën 01.07.2013 – 30.09.2013

- Auditimi për periudhën 01.10.2013 – 16.11.2013

Kompania ka përfunduar Fazën e parë të kërimit dhe ka kërkuar futjen në Fazën e dytë më datë 08.10.2013. Eshtë miratuar nga Komiteti Këshillimor më datë 28.01.2014.

Vlerësimi konkret lidhur me situatën aktuale në zbatimin korrekt të kërkesave të legjislacionit në fuqi

Hyrja e kompanisë në Fazën e dytë të kërimit, presupozon përmbushjen e të gjitha detyrimeve të Fazës së parë dhe depozitim të Garancisë Bankare për Fazën e dytë. Nga monitorimi në terren i të dy puseve të shpuar, rezulton se kompania nuk ka rehabilituar sheshet dhe rrugët e këtyre dy puseve. Kompania deklaroi me pare hyrjen në Fazën e dytë të kërimit dhe për këto depozitose edhe Garancinë Bankare për këtë Fazë.

Konkluzione.

Në Vlerësimin dhe kontrollin e shpenzimeve të realizuara në Fazën e parë të kërimit, nga dokumentat e paraqitura, mungon auditimi për periudhën: 01.04.2013-30.06.2013.

Nga kjo kompani, për të kaluar në Fazën e dytë të kërimit, duhet të plotësohen detyrimet e përmendura më lart:

- a) Vlerësimi konkret lidhur me situatën aktuale.
- b) Zbatim korrekt të kërkesave të legjislacionit në fuqi, (të depozitohet pranë AKBN-së Garancia Bankare).

4. Marrëveshja për blloqet “D-E”.

Vlerësimi konkret për zbatimin e afateve dhe procedurave administrative që lidhen me përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve që menaxhojnë marrëveshjet hidrokarbure

Marrëveshja për blloqet “D-E” është miratuar nga Këshilli Ministrave, me vendimin Nr. 796, datë 07.11.2007 dhe botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 165, datë 10.12.2007. Interesat e pjesëmarrjes në këtë kontratë janë 100% të kompanisë Petromanas Albania GmbH.

Pas përfundimit të Fazës së parë të kërimit, kompania kaloi në Fazën e dytë të kërimit. Kjo fazë parashikohej të zgjaste dy vjet, por me Amendimin që ju bë kontratës, me VKM Nr. 620, datë 24.07.2013, ajo u shty edhe për një vit dhe kështu Faza e dytë përfundoi më datë 10.12.2013.

Me përfundimin e Fazës së dytë, në respektim të kontratës, Neni 4.1.3, kompania duhet të njoftojë 30 ditë para kësaj date AKBN-në, për të hyrë në Fazën e tretë. Kompania e ka njoftuar AKBN me shkresë Nr. 143, datë 04.03.2014. Hyrja në Fazën e tretë të kërimit referuar Nenit 4.1.4 të kontratës, kushtëzohet me përfundimin e Programit të Punës për Periudhën e dytë të kërimit, ose kryerjen e pagesës në AKBN, për punimet e pakryera në këtë Fazë.

Programet e Punës dhe Buxhetet Vjetore.

Gjatë Fazës së dytë të kësaj marrëveshje, kompania ka hartuar Programet e Punës dhe Buxhetet Vjetore për realizimin e këtyre programeve.

Gjatë Fazës së dytë marrëveshja parashikonte të kryheshin këto operacione :

Studime G&G me shpenzime 300,000 USD.

Të shpohej një pus kërkimi jo më pak se 3 000 m, me shpenzime 6,000,000 USD.

Kompania ka përmbushur vetëm detyrimin e parë. Për detyrimin tjetër, atë të shpimit të pusit, të cilin nuk e ka realizuar, kompania ka paguar në AKBN shumën prej 6,000,000 USD. Per te hyre ne Fazen e Trete te Kerkimit kompania duhet te depozitoje Garancine Bankare per kete Faze, gje qe deri me sot kompania nuk e ka kryer.

Raportimet financiare.

Në lidhje me raportimet financiare, në zbatim të KNP, nga kompania Petromanas Albania GmbH, janë dërguar në AKBN, situacionet financiare të raportuar në 3-mujorë. Nga materialet që na u vunë në dispozicion, në Drejtorinë Ekonomike nuk janë situacionet ekonomike për periudhat : 01.10.2011 - 31.03.2012 dhe 01.07.2012-31.12.2012.

Vlerësimi dhe kontrolli i shpenzimeve të realizuara

Nga AKBN, për Fazën e parë të kërkimit , janë bërë tre auditime për shpenzimet e kryera në operacionet hidrokarbure të kompanisë Petromanas Albania GmbH, (Blloqet “A-B”, “D-E”, “2-3”, të përfshira).

- Auditimi për periudhën 01.04.2008 -30.09.2008.
- Auditimi për periudhën Gusht 2009- dhjetor 2010.
- Auditimi për periudhën 01.01.2011 – 30.06.2011.

Për Fazën e dytë të kërkimit nuk kishte materiale për auditimin e situacioneve të kryera për këtë Fazë.

Vlerësimi konkret lidhur me situatën aktuale në zbatimin korrekt të kërkesave të legjislacionit në fuqi

Hyrja në Fazën e tretë të kërkimit, referuar Nenit 4.1.4.të kontratës, kompania duhet të bëjë pagesën në AKBN, për punimet e pakryera te Fazës së dytë të kërkimit.

Gjithashtu, hyrja në Fazën e tretë të kërkimit, referuar kontratës për blloqet “D-E”, duhet t’i bindet edhe Nenit 29.4.të saj, i cili parashikon ekzekutimin dhe dorëzimin në AKBN , jo më vonë se 60 ditë, pas marrjes së vendimit nga Kontraktori, për të kaluar në Fazën e tretë të kërkimit, një Letër Garanci në formën e dokumentit sipas aneksit “E”.

Konkluzione.

Për Fazën e dytë të kërkimit, në Drejtorinë Ekonomike të AKBN-së, nuk kishte materiale për auditimin e situacioneve të kryera për këtë Fazë.

Nga materialet që na u vunë në dispozicion, në Drejtorinë Ekonomike mungojnë situacionet ekonomike për periudhat : 01.10.2011 - 31.03.2012 dhe 01.07.2012-31.12.2012.

Sipas Nenit 29.4 të kontratës duhet deponuar në AKBN, jo më vonë se 60 ditë pas marrjes së vendimit nga Kontraktori, për të kaluar në Fazën e tretë të kërkimit, një Letër Garanci në formën e dokumentit sipas aneksit “E”.

1. Marrëveshja për blloqet “2-3”.

Vlerësimi konkret për zbatimin e afateve dhe procedurave administrative që lidhen me përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve që menaxhojnë marrëveshjet hidrokarbure

Marrëveshja për blloqet “2-3”, është miratuar nga Këshilli Ministrave, me Vendimin Nr. 754, datë 08.07.2009, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 116, datë 31.07.2009. Interesat e pjesëmarrjes në këtë kontratë janë: Royal Dutch Shell 75% dhe Petromanas Albania GmbH 25%. Operatore është Petromanas Albania GmbH.

Programet e Punës dhe Buxhetet Vjetore.

Faza e parë e kërkimit ka një kohëzgjatje prej tre vjetësh dhe një Program pune ku përfshihen:

- Studime G&G dhe ripërpunimi i 150 km sizmikë egzistuese 2D me 500,000 USD
- Shpimi i një pusi kërkimi me një investim në total prej 8,000,000 USD.
- Kompania ka kryer volumin prej 550 km të profileve sizmikë 2D.
- Realizoi shpimin e pusit Shpiragu 2.

Në përfundim të shpimit dhe testimit të pusit, kompania deklaroi, me shkresë Nr.755,Prot, datë 13.12.2013, se ka bërë zbulim në pusin Shpiragu-2. Për këtë qëllim kompania paraqiti një Plan-Vlerësimi, i cili ka si objektiv të provojë komercialitetin e pusit Shpiragu-2. Ky Plan Vlerësimi, u miratua nga Palët në Komitetin Këshillimor, në datë 12.03.2014.

Faza e parë e kërkimit është zgjatur, në përputhje me Nenin 4.3 të KNP, për shkak të qenies në shpim të pusit Shpiragu-2 dhe 6-muaj të tjerë për testimin e naftëgazmbajtjes së tij.

Me miratimin e Plan-Vlerësimit, i cili perfundon ne Dhjetor 2015, kompania do te vleresoj parametrat e rezervuarit, rezervat e naftes dhe do te kryej shpimin e dy pusaeve te tjere, pusit Molishti-1 dhe Shpiragu-3.

Kompania Petromanas Albania GmbH, në përputhje me Nenin 4.3 të Marrëveshjes Hidrokarbure, me shkresën Nr.335, datë 02.05.2014, të dërguar në AKBN, njofton për hyrjen në Fazën e dytë të kërkimit dhe me pas me shkresen Nr. 477 Prot, date 19.06.2014, konfirmon deponimin e Garancise Bankare per hyrjen ne Fazen e Dyte.

Hyrja në Fazën e dytë të kërkimit sipas KNP, zgjat 2 vjet dhe ka si detyrim për tu realizuar nga kompania: G&G me 300,000 USD.

Të shpohet një pus kërkimi - 8,000,000 USD.

Raportimet financiare

Në zbatim të KNP, Petromanas Albania GmbH ka paraqitur të detajuar dhe raportuar për çdo 3-mujorë, situacionet financiare për blloqet '2-3'. Këto situacione përfshijnë periudhën 31.07.2009 – 31.12.2013. Shuma totale e kostos, e paraqitur në situacionet financiare, për Fazën e parë, është 180,765,596 USD.

Vlerësimi dhe kontrolli i shpenzimeve të realizuara

Nga AKBN janë bërë dy auditime për shpenzimet e kryera në operacionet hidrokarbure të blloqeve "2-3" të kompanisë Petromanas Albania GmbH, ku përfshihet dhe auditimi i blloqeve "A-B" dhe "D-E".

- Auditimi për periudhën Gusht 2009 – Dhjetor 2010.
- Auditimi për periudhën 01.01.2011 – 30.06.2011

Vlerësimi konkret lidhur me situatën aktuale në zbatimin korrekt të kërkesave të legjislacionit në fuqi.

Kompania e ka depozituar Garancinë Bankare për Fazën e dytë të kërimit.

Konkluzione

Në vlerësimin dhe kontrollin e shpenzimeve të realizuara, nga dokumentat që na u vunë në dispozicion, vërejmë se auditime për shpenzimet e kryera nga kjo kompani, janë bërë deri në 30.06.2011.

Kompania ka depozituar Garancinë Bankare, për Fazën e dytë të kërimit, njoftim ky i ardhur ne AKBN nga Banka perkatese dhe i konfirmuar edhe nga kompania Petromanas.

4. Marrëveshja për blloqet 2,3 dhe 4 në det.

Vlerësimi konkret për zbatimin e afateve dhe procedurave administrative që lidhen me përgatitjen dhe miratimin e dokumenteve që menaxhojnë marrëveshjet hidrokarbure

Marrëveshja për blloqet 2, 3 dhe 4, për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve, në det, është miratuar nga Këshilli i Ministrave, me Vendim Nr.383, datë 06.06.2012, ndërmjet Albpetrol sh.a.-së dhe shoqërisë Emanuelle Adriatic Energy Limited.

Programet e Punës dhe Buxhetet Vjetore.

Për Programin e punës dhe Buxhetin e vitit 2013, nuk është gjetur informacioni i duhur. Ndërsa përsa i përket Programit të Punës dhe Buxhetit për vitin 2014, u diskutua në mbledhjen e Komitetit Këshillues të kërimit të datës 24.12.2013, ku u vendos shtyrja e aprovimit të tyre.

Ndërkohë që ka përfunduar 6-mujori i parë i vitit 2014, AKBN nuk ka ende Programin e Punës dhe Buxhetin e vitit 2014, të aprovuar nga Palët në marrëveshje dhe të miratuar nga AKBN.

Për këtë shqetësim, AKBN i është drejtuar zyrtarisht kompanisë, me shkresat e saj Nr.5158 Prot, datë 22.07.2013 dhe Nr.1910 Prot, datë 24.02.2014 dhe nga kompania nuk ka ende asnjë reagim për këtë problem. Edhe mbledhja e Komitetit Këshillimor, midis kompanisë dhe Albpetrol, të mbajtur në datë

26.06.2014, për miratimin e Programit të Punës dhe Buxhetit 2014, nuk arriti të miratojë Programin e Punës dhe Buxhetin 2014.

Raportimet financiare.

Në bazë të Nenit 13.4, kompania ka detyrimin t'i dorëzohet Albpetrol-it dhe AKBN-së, një kopje të bilanceve të veta kontabël vjetore, brenda një afati 30 ditë pasi është dorëzuar te Autoritetet tatimore shqiptare. Afati ligjor nuk ka kaluar ende për dorëzimin e tyre.

I vetmi informacion financiar që disponohet, lidhur me situatën financiare të kësaj kompanie, është raporti i shpenzimeve sipas 3-mujorëve për vitin 2013, në formën e një shkrese dhe jo të një raporti të detajuar sipas marrëveshjes të dërguar në Albpetrol dhe AKBN.

Shpenzimet totale për vitin 2013 kapin vlerën 560,440 USD. Këto raportime nuk janë të detajuara siç parashikohet në Marrëveshje dhe nga ana e Albpetrol-it dhe e AKBN-së i është kërkuar kompanisë që raportimet e shpenzimeve financiare, të bëhen të detajuara në zëra, në përputhje me kërkesat e Liçencës.

Vlerësimi dhe kontrolli i shpenzimeve.

Informacioni i dërguar deri më sot, sipas Albpetrol, ka qenë i pamjaftueshëm dhe për këtë arsye, ka qenë i pamundur vlerësimi dhe kontrolli i shpenzimeve. Për të kryer vlerësimin dhe kontrollin e shpenzimeve të deritanishme, Albpetrol i ka kërkuar kompanisë dokumentacionin përkatës.

Vlerësim konkret për zbatimin e afateve dhe procedurave administrative që lidhen me përgatitjen dhe miratimin e dokumentave që menaxhojnë Marrëveshjet Hidrokarbure, ballafaqar me përcaktimet me marrëveshje dhe Liçencë marrëveshjet hidrokarbure përkatëse.

Kompania është në Fazën e parë të kërimit, fazë e cila zgjat 2,5 vjet dhe përfundon në datë 14.12.2014. Gjatë kësaj faze, në bazë të marrëveshjes, kompania duhet të zbatojë Planin minimal të punës me një investim total në vlerën prej 3,450,000 USD. Lidhur me zhvillimin e këtij Plani, sipas Albpetrol, nuk ka informacionet e duhura për të bërë një vlerësim të saktë.

Vlerësim konkret lidhur me situatën aktuale në zbatimin korrekt të kërkesave të legjislacionit në fuqi

Garancia Bankare e depozituar nga kompania, sipas AKBN-së, ka dy probleme:

- Është dorëzuar me vonesë në AKBN
- Jo në formatin e kërkuar nga Marrëveshja Hidrokarbure në shtojcën "E" të kontratës.

Dorëzimi i Garancisë Bankare në Marrëveshjen Hidrokarbure, Neni 29.3, parashikohet që të kryhet brenda 90 ditëve nga Data e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes Hidrokarbure, që korespondon me datën 14.09.2012, kur në fakt, ajo është dorëzuar në datën 10.04.2013, pra me rreth 7 muaj vonesë.

Konkluzione.

Nga informacioni i ardhur nga Albpetrol, në lidhje me raportimet financiare, i vetmi informacion financiar që disponohet, është raporti i shpenzimeve sipas 3-mujorëve për vitin 2013, në formën e një shkrese dhe jo të një raporti të detajuar sipas Marrëveshjes të dërguar në Albpetrol dhe AKBN.

Për vlerësimin dhe kontrollin e shpenzimeve, nuk është kryer asnjë auditim nga Albpetrol, për arsye të mungesës së informacionit për situacionet financiare.

Nga informacioni i ardhur nga AKBN, Garancia Bankare është dorëzuar me vonesë dhe jo sipas formatit të kërkuar nga Marrëveshja Hidrokarbure, në shtojcën “E” të kontratës.

Në vlerësimin Tuaj.

Grupi i Punës

Z. Dritan Spahiu	Kryetar
Z. Ilia Gjermani	Anëtar
Z. Alket Bllaci	Anëtar
Z. Eral Trasja	Anëtar
Z. Klodian Gradeci	Anëtar
Z. Agron Xhavo	Anëtar
Z. Anesti Moçi	Anëtar
Z. Eljon Semanaj	Anëtar
Z. Gledion Llatja	Anëtar
Z. Jovan Sota	Anëtar
Z. Zoto Leskaj	Anëtar
Znj. Alketa Mico	Anëtar
Z. Klevis Mezini	Anëtar